



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës  
Trajtimin ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës.

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot. Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023  
Nr. Dok. 202300854/2

**Lënda:** *Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisaratin e Policisë në Kuçovë.*

**Drejtuar:** Drejtues i parë Kastriot SKËNDERI  
Drejtoria Vendore e Policisë Berat

BERAT

Kryekomisar Enea KACI  
Komisariati i Policisë Kuçovë

KUÇOVË

*Të nderuar zotërinj,*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, si dhe duke vlerësuar angazhimin tuaj dhe të institucionit që ju drejtoni, në mbrojtjen dhe garantimin e lirive e të drejtave të personave që ju privohet liria në mjediset e Policisë së Shtetit, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi që institucioni i Avokatit të Popullit zhvilloi në Komisaratin e Policisë Kuçovë.

Inspektimi u zhvillua nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Inspektimi u krye në datë 29.09.2023, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda dhe znj.Gloria Çarkaxhiu me detyrë nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i vizitës inspektuese ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar dhe plotësimi i kushteve materiale në mjedisin e shoqërimit, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, si dhe procedurën standarde të punës "Rregullat për

*trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë” miratuar me Urdhër nr. 894, datë 19.07.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.*

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme.**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit nga MKPT në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e Komisarariatit të Policisë Kuçovë z. Enea Kaci, i cili u vu në dijeni të qëllimit të inspektimit.

Pasi u njoh me qëllimin e inspektimit, grupi i inspektimit u informua nga drejtuesi i komisarariatit në lidhje me gjendjen e kushteve në të cilat ndodhet në tërësi godina e institucionit dhe dhomat e shoqërimit, si dhe masat e marra për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto mjedise.

Në vijim, grupi i punës i MKPT-së inspektoi dhomat e shoqërimit, ambientet ndihmëse të saj, intervistoi personin e shoqëruar që ndodhej në dhomat e shoqërimit në momentin e inspektimit, si dhe këqyri e kontrolloi plotësimin sipas rubrikave të regjistrit ku evidentohen të dhënat e personave të shoqëruar/të ndaluar apo të arrestuar, librin e kërkesë/ankesave, regjistrin për të miturit në konflikt me ligjin, plotësimi i modelit të formularit të shoqërimit, si dhe ruajtja e administrimi i kopjeve të procesverbaleve të shoqërimit.

Krahas dhomave të shoqërimit, grupi i punës inspektoi edhe zyrat e specialistëve të policisë, pasi këto zyra shërbenin për kryerjen e veprimeve procedurale të intervistimit/marrjes në pyetje të personave të shoqëruar, në mungesë të dhomës më vehte të intervistimit të shtetasve.

Drejtuesi dhe punonjësit e Komisarariatit të Policisë Kuçovë, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë zhvillimit të inspektimit.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i kryer në Komisariatin e Policisë Kuçovë për vitin 2021<sup>1</sup>, rezultoi se:

*Nuk ishin plotësuar rekomandimet, si më poshtë vijon:*

- ✓ për rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës të Komisarariatit të Policisë Kuçovë, në këtë kuadër dhe mjedisit të shoqërimit, me qëllim krijimin e kushteve dinjtoze të qëndrimit dhe trajtimin e personave të shoqëruar, si dhe, për të garantuar kushte të përshtatshme pune për punonjësit e policisë së këtij institucioni.

---

<sup>1</sup> Dërguar rekomandimi për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Kuçovë me shkresë nr. K4/157-2 prot, datë 13.12.2021.

- ✓ për ndërtimin e 3(tre) dhomave të shoqërimit, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr.894, datë 19.07.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
- ✓ për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur në konflikt me ligjin, një ambient më vehte i cili duhet të jetë i përshtatshëm dhe i kompletuar me orënditë e nevojshme, për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
- ✓ për krijimin e zyrës (dhomës) më vehte ku merren në pyetje personat e shoqëruar (të ndaluar/arrestuar), si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera brenda këtij ambienti.
- ✓ për eliminimin e lagështirës në ambientin e dhomave të shoqërimit, në tualete, si dhe në korridorin e katit të parë të komisariatit.
- ✓ për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e paisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
- ✓ për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese, në korridorin e ambientit të shoqërimit të këtij komisariati.

*Ndërkohë, ishte zbatuar rekomandimi:*

- ✓ për lyerjen, dizifektimin dhe higjenizimin e dhomave të shoqërimit.

Nisur nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit, por dhe nga inspektimi i kryer në ambientet e shoqërimit, në Komisarariatit të Policisë Kuçovë vijojnë të jenë të pranishme disa problematika.

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre.**

Ambienti i shoqërimit në Komisarariatit të Policisë të Kuçovë, është i ndërtuar pjesërisht sipas normave dhe parametrave të parashikuara në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurën standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë”, në të cilat përcaktohet se, “*këto mjedise/ambiente duhet të jenë të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit*”<sup>2</sup>.

Në mjedisin e shoqërimit ndodhen 2(dy) dhoma shoqërimi të ndara më vehte një “për të rritur”, dhe tjetra “për femra dhe të mitur”. Dhomat e shoqërimit kanë përmasa 4x3m, me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve. Ato ishin të kompletuara me tavolina dhe stola, për të mundësuar qëndrimin ulur deri në 4 persona.

Dritaret e dhomave të shoqërimit kanë përmasa të tilla, që siguronin ajrim dhe ndriçim të plotë natyral. Ato ishin të siguruara me skarrë hekuri, por ajo ishte e montuar në pjesën e brendshme të dhomës së shoqërimit. Në kushtet që skara e hekurit ishte e vendosur, në vlerësimin tonë dhe me qëllim parandalimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme, hekurat e

<sup>2</sup> Kreu VII, pika 4 e procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

skarës përbëjnë shkak ose premisë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë<sup>3</sup>.

Dhomat kanë edhe ndriçim artificial që furnizohet nga rrjeti elektrik. Ato mbyllen me dyer prej druri dhe ishin të siguruara nga jashtë me çelës.

Gjatë inspektimit u konstatua se, dhomat e shoqërimit ishin të pastëra nga ana higjieno-sanitare, por është e nevojshme që ato të lyhen dhe të dizifektohen në mënyrë të vazhdueshme, për shkak të lagështirës. Në dhomat e shoqërimit nuk ka sistem ngrohjeje/ftohje, por nga informacioni, institucioni **nuk** disponon as pajisje elektrike që mund të përdoren për ngrohje në rastet kur ulen temperaturat.

U konstatua gjithashtu se, në ambientin e shoqërimit mungon një dhomë e veçantë shoqërimi dhe intervistimi për të mitur në konflikt me ligjin. Mungesa e dhomës së shoqërimit dhe intervistimit për të mitur, është në kundërshtim me kërkesat e kreut VII, pika 4 të procedurës standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, ku parashikohen masat për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave të mitur në mjediset e policisë, si dhe në rastin kur strukturat e policisë dhe organet e tjera kryejnë veprimtari administrative në kuadrin e drejtësisë penale për të mitur.

Në fundin e korridorit të dhomave të shoqërimit ndodhej 1(një) tualet i përbashkët që përdorej nga personat e shoqëruar, ndërkohë që sipas standardit në ambientin e shoqërimit duhet të jenë dy tualete të ndara për burra dhe për gra, më vehte<sup>4</sup>. Tualeti ekzistues ishte i pajisur me çezëm me rubinet dhe pajisje hidro-sanitare, si dhe kishte ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje gjatë 24 orëve.

Nga inspektimi, u evidentua se gjendja teknike e godinës së komisariatit ishte e amortizuar dhe kishte nevojë për ndërhyrje të menjëhershme për rikonstruksionin e saj. Dhomat e shoqërimit dhe ambientet në Komisaratin e Policisë Kuçovë edhe pse ishin të lyera, në vende të caktuara, kishte rënë suvaja për shkak të lagështirës që ishte prezente kudo. Ky shqetësim, u evidentua edhe nga drejtuesit e komisariatit, pasi lagështira ishte evidente në gjithë godinën e komisariatit, por më e theksuar ishte në ambientet e katit të parë të godinës dhe në tualete.

Në këtë komisarjat, ende nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të ambienteve të këtij institucioni, një konstatim i cili është i përsëritur edhe nga inspektimi i mëparshëm. Në kushtet e vendodhjes së komisariatit, si dhe për të

---

<sup>3</sup> Kreu VII, pika 4/f,g e procedurës standarde thehet shprehimisht se: “f. Në të gjitha mjediset të mos mbahen sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë. g. Dritaret e këtyre mjedisëve të jenë të siguruara me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedisë.”

<sup>4</sup> Kreu VII pika 4 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, ku përcaktohet se: “Brenda këtyre ambineteve ose ngjitur me to, duhet të ketë tualete, të ndara për femra dhe meshkuj, të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim”.

garantuar sigurinë e personave të shoqëruar, është e domosdoshme instalimi i sistemit të kamerave në ambientet e brendshme dhe të jashtme të tij.

Mbikqyrja me kamera e të gjitha mjediseve të komisariatit, përveç atyre mjediseve ku çenohet privatësia, është vlerësuar nga ana e institucionit tonë, si një proces thelbësor për tre arsye:

**Së pari**, mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

**Së dyti**, mbikqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të komisariatit, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

**Së treti**, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet përkatëse që hartojnë institucionet monitoruese të pavarura.

Në momentin e inspektimit në Komisarlatin e Policisë Kuçovë, ndodhej vetëm një person i shoqëruar në moshë madhore, i cili ishte në gjendje të mirë shëndetësore dhe nuk paraqiti asnjë pretendim për punonjësit e policisë. Ndërsa, për periudhën janar-tetor 2023, ishin shoqëruar apo ndaluar/arrestuar 98 persona, nga të cilët 1(një) grua, 1(një) i mitur dhe pjesa tjetër ishin në moshë madhore.

Nga inspektimi u evidentoi se, personat e shoqëruar nga policia informoheshin për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke iu siguruar informacion verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. Ndërkohë, Avokati i Popullit në kuadër të respektimit të të drejtës për informim të personave të shoqëruar në mjediset e Policisë së Shtetit, ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur dhënien e kartës të të drejtave për personat e shoqëruar, që nga fillimi i privimit të lirisë, në momentin e hyrjes së tyre në komisarlat. Ky është një standard i ri që garanton njohjen me të drejtat shtetasve që shoqërohen në këto mjedise, i cili është i shprehur qartë edhe në rekomandimin e KPT (CPT) në raportin e tij të botuar në vitin 2019, në përfundim të vizitës inspektuese të zhvilluar në Shqipëri në vitin 2018.<sup>5</sup>

Gjatë inspektimit nuk konstatoi raste dhe nuk administroi asnjë ankesë, në lidhje me pretendimet e personave të shoqëruar për ushtrim dhune apo trajtim degradues. Kjo, u verifikua edhe nga regjistri i kërkesë/ankesave të të shoqëruarve ku rezultoi se, për vitin 2023 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

---

<sup>5</sup> shih: <https://rm.coe.int/16808ae48f> "Report to the Albanian Government on the visit to Albania carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT)".

Marrja në pyetje dhe intervistimi i personave të shoqëruar, në mungesë të një ambienti më vete, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Në këto kushte, u inspektuan edhe zyrat e specialistëve të policisë gjyqësore në në këtë komisariatit, ku rezultoi se, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen apo merren në pyetje nga specialistët e policisë.

Në vijim të inspektimit, u verifikuan edhe disa praktika të njëpasnjëshme të ndjekura me personat e shoqëruar, ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të komisariatit, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre.**

Në Komisaratin e Policisë Kuçovë nuk ka ambient sigurie. Personat e arrestuar/ndaluar nga punonjësit e policisë, në përfundim të veprimeve procedurale, dërgohen menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisaratin të Policisë Fier<sup>6</sup>.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre.**

Në Komisaratin e Policisë Kuçovë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”, ishte i tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr.894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ky regjistër, në faqen e fundit të tij ishte i protokolluar dhe i sekretuar.

Personat e shoqëruar në organin e policisë, nga verifikimi në regjistër, ishin sipas kushteve të parashikuara në dispozitat e ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Të dhënat e personit të shoqëruar, menjëherë pas plotësimit të formularit të shoqërimit nga punonjësi i policisë që kryen shoqërimin e personit në mjedisin e policisë, regjistrohej në regjistër nga punonjësi i zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e regjistrit, rezultoi se koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 4 orë (por jo më shumë se 10 orë në raste të veçanta), sipas afatit kohor të parashikuar në ligjin “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurën standarde, për këtë qëllim. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë<sup>7</sup>.

Në këtë komisariat kishte edhe regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e arrestimeve dhe ndalimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, në rastet e

---

<sup>6</sup> Dhomat e sigurisë në DVP Berat, për mungesë të kushteve dhe kritereve për ndertimin e tyre, si dhe në zbatim të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, janë mbyllyr me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. **Deri në ndërtimin e ambienteve të reja, personat e ndaluar/arrestuar nga komisaritet e policisë të DVP Berat, dërgohen në dhomat e sigurisë të DVP Fier.**

<sup>7</sup> Kreu VII, Procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit në procesverbalet e ndalimit në dhomat e sigurisë, përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë, që në momentin e privimit të lirisë.

Në zyrën e informacionit të komisarariatit, u evidentua se kishte një regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për periudhën që u krye inspektimi, nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë nga personat e shoqëruar.

U konstatua gjithashtu se, të dhënat për personat e mitur në konflikt me ligjin regjistroheshin në një regjistër të veçantë. Nga këqyrja e regjistrit, rezultoi se për vitin 2023, ishin evidentuar të dhënat për një person të mitur të shoqëruar. Ky regjistër, ishte hapur në zbatim të rekomandimit të Avokatit të Popullit, për marrjen e masave, për pajisjen e komisariateve të policisë me një regjistër të posaçëm dhe evidentimin e të dhënave për personat e mitur në konflikt me ligjin<sup>8</sup>.

Në zyrën e informacionit, ndodhej edhe një regjistër për takim me avokatin mbrojtës, në rastet kur kërkohej nga të shoqëruarit, si dhe dosja me kartën e të drejtave të personave të shoqëruar apo ndaluar/arrestuar në gjuhën shqipe dhe në disa nga gjuhët e huaja më kryesore.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisariatin e Policisë së Kuçovës, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente **nuk** janë të monitoruara me kamera, që do mundësonte mbajtjen në vëzhgim të oficerëve të policisë gjyqësore, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale apo kundërveprimet e paligjshme të të shoqëruarve ndaj punonjësve të policisë.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga konstatimet në inspektimin e mëparshëm, ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrës (dhomës) më vehte ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në dhomat e intervistimit, rekomandim i cili ende **nuk** ka gjetur zbatim, si në Komisariatin e Policisë Kuçovë ashtu edhe në komisarariatet e tjerë në varësi të DVP Berat.

Avokati i Popullit, referuar standardeve ndërkombëtare<sup>9</sup> e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut,

<sup>8</sup> Detyrim i përcaktuar nga ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

<sup>9</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2016[par.18]

pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Gjithashtu, Komisariati i Policisë Kuçovë nuk ka një hapësirë të posaçme (dhomë) për biseda apo intervistim me persona të mitur. MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të tillë që të shërbejë për zhvillimin e bisedave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve.

Nga inspektimi që ju bë zyrave të punonjësve të policisë në këtë komisarariat, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat që merren në pyetje në këto ambiente.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Nga informacioni i drejtuesit dhe punonjësve të policisë, rezultoi se, në rastet kur të shoqëruarit apo të ndaluarit/arrestuarit në moshë madhore, të cilët nuk kanë mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkojnë ndihmë juridike falas, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht, nga lista e avokatëve të miratuar nga organi i Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor, Berat. Kjo listë, ishte e afishuar në zyrën e informacionit të komisarariatit.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet proceduriale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut. Psikologu është në organikë të DVP-së Berat, por për raste të veçanta, sigurohej edhe në bashkëpunim me shkollën e mesme të qytetit Kuçovë. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar të mitur u konstatua se, procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Kuçovë, ishte zhvilluar konform ligjit.

Në raste kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata i shoqërojnë në qendrën shëndetësore Kuçovë, për të marrë ndihmën mjekësore.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridorin e ambientit të shoqërimit dhe brenda në dhomat e shoqërimit, ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë, si dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien në momentin e lënies të lirë, një kopje e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit



dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Rezultoi gjithashtu se, ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë plotësohej “*Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit*”. Një kopje e formularit të shoqërimit dhe procesverbalit të shoqërimit, ruhej në sekretarinë e këtij institucioni.

Në zbatim të kërkesave të parashikuara në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të K.Pr. Penale, personat e ndaluar/arrestuar, në përfundim të veprimeve proceduriale, para se të dërgoheshin në dhomat e sigurisë në DVP Fier, pajiseshin me vete me një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, procesverbalit të dorëzimit të sendeve personale dhe kopje të kartës me të drejtat.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

### **REKOMANDOJMË:**

1. Të merren masat e nevojshme, për sigurimin e fondeve buxhetore, me qëllim rikonstrukcionin e përgjithshëm të godinës së Komisaritit të Policisë Kuçovë, në këtë kuadër edhe të dhomave të shoqërimit, me qëllim krijimin e kushteve dhe trajtimin dinjitoz të personave të shoqëruar, por dhe kushte të përshtatshme pune për punonjësit e policisë të këtij komisarati.
2. Të merren masa të menjëhershme, për heqjen e skarës së hekurit që është e montuar në pjesën e brendshme të dritareve në dhomat e shoqërimit, me qëllim parandalimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme, të largimit apo edhe arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise.
3. Të merren masat e menjëhershme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera sigurie, ruajtjen e pamjeve filmike, për mbajtjen në vëzhgim të ambienteve të jashtme dhe korridorit të dhomave të shoqërimit në këtë komisarati.
4. Të merren masat e nevojshme, për eliminimin e lagështirës në ambientin e dhomave të shoqërimit, si dhe në ambientet e tjera ndihmëse të komisaritit.
5. Të merren masat e nevojshme, për krijimin e 3(tre) dhomave të shoqërimit në komisarati, më vehte për personat e shoqëruar burra, për gratë dhe për të mitur në konflikt me ligjin, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr.894, datë 19.07.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

6. Të merren masat e nevojshme, për krijimin e dhomës së intervistimit apo marrjes në pyetje të personave të shoqëruar, të ndaluar/arrestuar, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këtë ambient.
7. Të merren masat e nevojshme, për krijimin e një ambienti të posaçëm për intervistimin e të miturve në konflikt me ligjin, duke ofruar një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
8. Të merren masat e nevojshme, për sigurimin e ngrohjes/ftohjes në dhomat e shoqërimit, nëpërmjet sigurimit të pajisjeve elektrike, kryesisht në periudhën e dimrit.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ahmet PRENÇI**